



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 20 pika 1.1 dhe 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 24 pika 1.1 dhe 1.6 të Statutit të OFTK-së, dhe vendimit të Këshillit Drejtues nr. 360 të datës 09.07.2021, Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës shpallë këtë:

K O N K U R S

Për këtë pozitë të punës:

I. Titulli i vendit të punës: Jurist

Norma e punës: Gjysmë orar për nevojat e OFTK-së
Kontrata: 6 mujore me mundësi vazhdimi pas vlerësimit të performancës nga Kryetari OFTK-së
Raporton: Kryetarit të OFTK-së
Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Harton vendimet që kanë të bëjnë me punëtorët;
- Monitoron dhe këshillon komisionet e OFTK-së për punën e tyre.
- Harton vendime të ndryshme të cilat i lëshon organet e OFTK-së t;
- Siguron dhënien e konsulencës juridike për problematikat që mund të lindin pranë OFTK, dhe bën saktësimin e hapave proceduralë që do të ndërmerren në raste të tilla.
- Kontribuon në zgjidhjen e kërkesave për gjetjen e opsioneve dhe hapsirave ligjore mbi problemet që parashtrohen në rrugë administrative.
- Bën interpretim juridik të akteve ligjore, nënligjore për zgjidhjen e problematikave në sektorin fizioterapeutik.
- Shqyrton dhe harton përgjigjet e kërkesave dhe ankesave ndaj punës së organeve të OFTK-së
- Kryen edhe punë tjera të natyrës juridike të përcaktuara nga Kryetari i OFTK-së

Shkollimi i kërkuar:

- Diploma Universitare e Fakultetit juridik

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Diploma e Fakultetit juridik
- Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.
- Dëshmi për përvojën e punës.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë,
- Të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurse :

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, si dhe të ketë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e mbylljes së konkursit: **15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.**

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet, dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00-14:00 në zyrat e OFTK-së

Adresa: Kompleksi i QKUK-së - Instituti A (Instituti i Anatomisë), Kati i III-të, RKS-10000 Prishtinë.

Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

